

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut dhe mos u përçani" (Ali-Imran 103)

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder
 Vitit I i botimit, Mars 2008 Nr 11. Çmimi 20 lekë.
 www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it
 Kryeredaktor Selim Gokaj



Gëzuar Pavarësinë e Kosovës

SIMPOZIUM MADHESHTOR I FORUMIT MUSLIMAN TE SHQIPERISE



Problemi i integritetit të shqiptarëve në Evropë është një temë e cila trajtohet në mënyrë të pandërprerë në mediat shqiptare duke bërë rrallë here ndonjë pauzë, sikur ata që i përgadisnin tezat për këtë integritet, grumbullojnë forcat për të bërë përsëri në mediat shqiptare të njëjtin trajtim të temës, por duke dhënë sipas tyre argumenta pro dhe disa here jo në emër të atyre që ata i paraqesin pengesë për integritetin e shqiptarëve në Evropë, shkaqe që gjithmonë janë të ngritura mbi baza mashtrimi dhe manipulimi për të fituar edhe një vijë më shumë në gradat e tyre që përgjithësisht i marrin si dhuratë nga të huajt për shërbimet që ata i bëjnë jo për Shqipërinë, por për ata që shpërndajnë gradat për rajatë e tyre. Janë pikërisht këta raja që vdesin për shërbim dhe gradat të huaja të cilët lakojnë idenë se të qenurit shumicë muslima e shqiptarëve është faktikisht shkaku që në shqiptarët po rrijmë pas dyerve të Evropës dhe presim mos do të na pranohet edhe ne në Evropë, sepse po ju rrijmë gati nën urdhra për 24 orë. Por, e vërteta është se muslimanët shqiptarë kurrë nuk kanë qenë pengesë për integritetin e Shqipërisë në Evropë sepse feja islamë nuk përfaqëson regres. Ajo kurdoherë ka rrezatuar vlera që kanë qenë në shërbim të vetë kombit shqiptar. Në kuadër të paraqitjes së këtyre vlerave, me datën 2 shkurt 2008, në Kavajë u organizua një simpoziум nga Forumi Musliman i Shqipërisë me temë: "Integriteti i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami përcjell në këtë

integritet". Ajo që të bënte shumë përshtypje në këtë simpoziум ishte një pjesëmarrje e gjërë, duke filluar nga përfaqësues të strukturave të larta shtetërore e duke vazhduar tek ato lokale, pa harruar se pjesëmarrja zgjerohej edhe më shumë në përfaqësuesit e Forumit Musliman të Kosovës, Bashkësisë Islame të Kosovës, Bashkësisë Islamë të Maqedonisë dhe Bashkësisë Islame të

Malit të Zi. Aktivitetin e hapi Z. Nexhmi Haveriku, organizatori i këtij aktiviteti dhe njëkohësisht n/ kryetar i Forumit Musliman të Shqipërisë, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe u uroj atyre mirëseardhjen dhe njëkohësisht i falenderoi ata për vlerësimin që i bënë simpoziумit i cili u reflekuar më pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet. Pastaj e mori fjalën Z. Fisnik Kruja, kryetari i Forumit Musliman të Shqipërisë i cili përshëndeti dhe vlerësoi pjesëmarrjen e z. Rasim Hasanaj, Kryetar i Komitetit Shqiptar të Kulteve, z. Ruzhdi Keçi, prefekti i Qarkut të Tiranës, z. Bardhyl Rexha, Prefekti i qytetit të Kavajës, ZRefik Rugeja, kryetar i Bashkisë së Kavajës, z. Aqif Haveriku, Kryetar i Këshillit të Rrethit të Kavajës, duke u shtuar këtyre përshëndetjeve edhe përshëndetje për të gjithë të ftuarit e tjerë. Të bënte shumë përshtypje pjesëmarrja shumë e madhe në sallë dhe po kaq përshtypje të bënte ardhja e thujtës të të gjithë të ftuarve që ishin caktuar për të referuar në këtë simpoziум. Të gjithë ata që ndoqën punimet e këtij simpoziумi nuk mund ta shlyejnë lehtë atë nga kujtesa, sepse paten rastin të percjellin punime shumë dinjitoze nga referuesit që, për hir të së vërtetës, duhet pranuar se janë pjesa më pikante e atij skalioni që mbron interesat e muslimanëve dhe vlerat e fesë islame Duke pasë parasysh se referuesit ishin të shumtë dhe koha ishte e rezervuar në shtrirje, të pranishmit

u privuan pak nga vlerat e plota të tema që u referuan në këtë simpoziум. Por, megjithatë, temat që u mbajtën nga z. Abdi Baleta, z. Bashkim Aliu, z. Milazim Krasniqi, z. Olsi Jazexhiu, z. Ajni Sinani z. Fuad Ramiq, z. Faik Miftari z. Roald Hysa lane një përshtypje të veçantë për shkallën e lartë shkencore dhe politike në trajtimin e punimeve të tyre që kishin lidhje me problemet me të cilin përballohen sot muslimanët shqiptarë në hapësirat ku jetojnë sot. Nuk janë të paktë qarqe dhe individë të caktuar që mundohen ta paraqesin Forumin Musliman të Shqipërisë si një bashkësi e vogël individësh që flasin në emër të një mase të madhe muslimanësh. Ky simpoziум ishte përgjigja më e mire për këto segmente jodashamirëse për muslimanët, sepse ai tregoi potencialin e vërtetë të Forumit Musliman të Shqipërisë i cili është i aftë dhe i kompletuar të reagojë publikisht për ata probleme që kanë lidhje me çënimet e identitetit të muslimanëve në Shqipëri dhe më gjërë dhe nga ana tjetër është i aftë të organizojë aktivitete me përmasa të papara ndonjëherë në këto 17 vite të demokracisë. Mendojmë që institucionet, që përfaqësojnë hierarkinë e lartë të muslimanëve në Shqipëri, duhet të kishin pranuar ftesën që Forumi Musliman i Shqipërisë u bëri atyre për të qenë pjesë e këtij aktiviteti, sepse qarkore të lëshuara për të anashkaluar simpoziумin i Forumit Musliman të Shqipërisë për institucionet islame në bazë nuk i shërbejnë muslimanëve shqiptarë të cilët sot, më shumë se kurrë, duhet të jenë të bashkuar për të rritur numurin e forcave që veprojnë në mbrojtje të interesave të muslimanëve në Shqipëri dhe për të mbrojtur gjithashtu vlerat hyjnore të fesë islame.

Moment shumë i rëndësishëm i këtij aktiviteti ishte dhenia e tiullit "Qytetar Nderi" ish-imamit të Kavajës, z. Muhamet Hoxha, një hoxhë i nderuar që ka mbetur i paharruar për të gjithë besimtarët e Kavajës. Mendoj se duhen falenderuar edhe vëllezërit Haveriku që e sponsorizuan këtë simpoziум duke vënë në shërbim të tij edhe lokalitetin e tyre që pa tjetër ishte pjesë me rendësi e suksesit të këtij aktiviteti. Pasdite vonë, simpoziумi i mbylli punimet e veta duke lënë pas detyra të reja për Forumin Musliman të Shqipërisë që ai ta rrezatojë edhe më shumë aktivitetin e tij që të vazhdojë të jetë pjesë shumë e rëndësishme e mbrojtjes së çështjes islame në Shqipëri dhe gjithashtu të vazhdojë të jetë mbrojtës i identitetit të muslimanëve në Shqipëri.

Selim Gokaj Shkodër, me 5 shkurt 2008

TURQIA DHE VENDET E KONFERENCES ISLAMIKE Fq 2
KRONIKË E PROMOVIMIT TË LIBRIT 'FJALË FRYMËZUESE' Fq 3

DEBATET PER ANETARESIMIN E SHQIPERISE NE KONFERENCEN E VENDEVE ISLAMIKE Fq 4
RREFIME ANTIISLAME TE NJE AGJENTI TE NJOHUR ANGLEZ Fq 5

TE GJITHA FAJET NUK ISHIN TE HAXHI QAMILIT Fq 6
FERMANI I FATIH SULLTAN MEHMETIT Fq 7

TURQIA DHE VENDET E KONFERENCES ISLAMIKE NDER TE PARAT QE NJOHIN PAVARESINE E KOSOVES



Ashtu si pritej nga analistët dhe opinioni publik ndërkombëtar dhe pa tjetër edhe nga faktori politik shqiptar, në veçanti nga populli shqiptar i hapësirës kosovare, Kosova e shpalli Pavarësinë e saj me 17 Shkur 2008, duke realizuar kështu aspiratën e saj shekullore e cila tashmë, nga një ender, është bërë realitet. Kuptohet se kjo është një Pavarësi e Kushtëzuar dhe jo ajo për të cilën luftuan dhe ranë në fushëbeteja dhe u zhdukën nëpër burgjet famekeqe serbe ata që ishin në vijën e parë të betejave kundër serbëve, duke shtuar edhe qindra e mijra civilë të pafajshëm që u shfarosën nga kriminelët serbë vetëm se ishim shqiptarë. Ata që paten fatin të ishin në Kosovë me 17 shkurt dhe ata që ishin fatlum që e ndoqën këtë ditë madhështore përmes mediave, përjetuan një mrekulli të cilën mundën ta shijojnë vetëm shqiptarët dhe miqtë e tyre që kanë qenë të sinqertë në krah të popullit kosovar sot dhe kurdoherë, pa u lakuar dhe pa përdredhur për asnjë çast.. Ishte më shumë se festa për Pavarësinë e Kosovës ai tubim i paparë në trojet shqiptare duke na bindur se shqiptarët shfryëzuan një mundësi të rrallë për t'u mbledhur së bashku, sepse atë ditë mund të shikoje në manifestim shqiptarë nga Saranda dhe nga Ulqini, nga Shkodra dhe nga Tetova, nga Presheva dhe nga Shkupi. Të gjithë ishin të mbuluar me flamuj kombëtarë duke provuar një ndjenjë të cilën njeriu e provon vetëm një here në jetën e vet. Ceremonia e shpalljes së Pavarësisë ishte organizuar me deklaratën e kryeministrit Thaçi, që u pasua nga aprovimi i saj në Parlamentin e Kosovës dhe pak më vonë do të ishte kryetari i këtij parlamenti, Jakup Krasniqi, i cili, në emër të Parlamentit të Kosovës, do të shpallte Pavarësinë e Kosovës. Tashmë Kosova është shpallur i Pavarur dhe do të nisë rrugën e saj drejt afirmimit dhe njohjes nga faktori politik ndërkombëtar që edhe ka bërë premtimin se do ta njohe shtetin më të ri në Evropë dhe do ta mbështete integrimin e tij rajonal dhe evropian, me qëllim që Kosova e Pavarur të jetë pjesë edhe e organizmave më të

rendësishme, siç është OKB. Ashtu sikur pritej ishte Turqia që e njohu e para Pavarësinë e Kosovës dhe pas saj, në një hark kohor ditësh, do të jetë Konferenca e Vendeve Islamike që do të shpallë njohjen e Pavarësisë së Kosovës, duke e çuar numurin e vendeve që njohën këtë Pavarësi, mrenda pak ditësh, tek shifra 60. Do të pasonin njohjen e Pavarësisë së Kosovës SHBA Anglia, Franca, Gjermania duke e çuar numurin e vendeve që pa njohin Pavarësinë e Kosovës, në këto momente kur ne po pregaditemi për të botuar këtë shkrim, tek shifra 90. Por, shteti më i ri i Evropës do të nxiste një histeri të egër kundërshtimi nga Serbia dhe aleatja e tij historike dhe e rrezikshme, Rusia. Do të ishte qeveria e Beogradit që do të organizonte demonstrata të dhunshme në Beograd që do t'u vinin flakën ambasadave amerikane, turke dhe gjermane si ambasada të shteteve që e mbështeten Kosovën në rrugën e saj drejt Pavarësisë. Sidomos, Mitrovica po bëhet arenë e sulmeve të dhunshme kundër policisë kosovare dhe asaj ndërkombëtare të cilat po masakrohen me gurë, bomba dhe shishe me benzinë. Koha që do të vijë pas do të tregojë, ne pa tjetër që do të jemi dëshmitarë, se deri ku do t'u lihet hapësirë serbëve të Serbisë dhe serbëve të Kosovës, që t'u tregojnë dhëmbët kosovarëve dhe faktorit ndërkombëtar që po i mbështet sot kosovarët që tashmë kanë shpallu shtetin e tyre të pavarur. Ajo që të shqetëson është qëndrimi i egër i Rosisë me presidentin e saj, Putin, i cili ka kërcënuar me një ndërhyrje në Kosovë me trupa ruse duke bërë përpjekje të na kujtojë një deklaratë të tij se një Kosovë e Pavarur mund ta çojë botë drejt një lufte të re me përmasa globale. Por, duket se Perëndimi dhe SHBA janë shumë të vendosura që të mbështesin Pavarësinë e Kosovës edhe në qoftë se kjo mbështetje do të kërkojë një kosto të lartë, sepse duket që, pas Pavarësisë së Kosovës, fshihen ngjarje të clat duket se janë pjesë e strategjisë globale të fuqive perëndimore dhe vetë të SHBA që bota ka mundësi t'i përjetojë ato së shpejti të cilat urojmë që të jenë në dobi të vetë njerëzimit.

Alban Kastrati Shkodër, me 26 shkurt 2008

OSO KUKA

Zot ç;ka than njaj Avdi pasha
Paska mbet Shqipnia n'vasha
Qysh se s'leka mrenda një djal
N'at Vraninë mue sod me m'dalë
N'at Vraninë ,m'at t; zezë thertore
Ku m'beten shkret sa armë mizore
Ku mbet djerr sa tok gratçore
Ku mbeten vithnat pa bagti
Veç prej cubave t, Malit t'Zi
Qi po vrasin djem e ri
Qi po marrin lopët me viça
Qi po presin dhentë me oqiça
E po djegin kulla e stane
E po thajn kaq zemra nane!
Eh!po, Kjnazi ke Cetina
Ka lshue cubat kah Vranina
Për me vra ata e për me pre
Për me djegun gur e dhe
Veç si t;nisë degamë me ne
Pse dushmani asht tue ndërsy
Tokët e Mbretit për me msy
Për me i msye e me i rrëmbye.
Nji djalm' voter t'm'ishte le
Paçë m'i a lane tamen me fsha
Paç m;i a lanë motrën me kja
T'mjerën motër shu! Pa vlla.
E; Vraninë un kjeçë tue e qitun
Cubat Knjazit m' i a pritun.
Por mue djalë nuk m;ka qillue
En; Shqypni një djal drague
T'cillit mos t;i dhimbet jeta
Për dovet e troje t,veta
Fort kërkove e s' mund gjeta.
Kshtu ankoj pasha turçeli.
.Oso Kuka paska ndi
Paska ndi e kenka idhnie.
Me qit n' Pashën ka mendue
Por i urti kurr nuk ngutet
Prej burris e jo prej tutet.
Prandaj Osja ndali dorën
E as m'nxerr s;e nxuer mizoren.
Veç pa i folë s' mujt me durue:
Avdi Pashë tha , ma kadalë!
Mos e thuaj dy here at fjalë,
Se për din e për iman
T' baj qi t' kjaç e zeza nanë
T' baj qi t'kjaç pa exhel ty nana
Pse n' Shqypni ka djem si zana
Qi për Mbret e troje t'veta
Nuk i dhimbet gja as jeta.
E ku i lypë besa e burrnija
Ku i lypë Mbreti e i lyp Shqypnia
Kta ma t'parët janë në fushë t'mejdanit
Kta ma t'rrebët janë n' ball t' dushmanit:
Janë çelik për teh t'taganit.
Marre vedit kurr s;lame!
Pa ksulë n;krye , pa opangë n' kambë
Na për Mbret e për Atdhe
Për kanu e besë e fe
S'drum me ra nder pre të pathyeshme
S'drum me msy kalat e rrmyeshme.
E kahdo qi t' bjerë shqiptari
Shkon rrufeja tue ndezë zhari
Pushkë e besë pse na la i pari.
Avdi Pasha kenka çue,
Osos dorën ka shtërngue
Aferim bre Oso Kuka!
Se ty t' thotë fjala edhe duka

Marrë nga Lahuta e Malësisë

Kronikë e promovimit të librit 'Fjalë Frymëzuese'



Më datën 3 Shkurt 2008, në orën 10.30, në sallën e madhe të konferencave në "Grand Hotel Europa", u bë promovimi i librit 'Fjalë Frymëzuese' të autorit Mirsad Sylja.

Në promovim merrnin pjesë miq nga Kosova, autoritete të ndryshme të qytetit të Shkodrës, duke filluar nga myftiu i Shkodrës, Imam Ndrëçim Sulejmani; drejtori i medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi; zv/ Kryeimami i "Bashkësisë Islame të Kosovës", z. Sabri Bajgora; drejtori i medresesë "Alaudin" në Prishtinë, z. Ekrem Simnica.

Merrnin pjesë mësues nga medreseja "H. Sh. Shamia", studiues të ndryshëm, teologë, miq e të afërm të Mirsadit.

Në promovim referoi teologu Ilir Bejtja, i cili ndër të tjera tha:

"...në këtë libër ka një përputhje të plotë mes titullit dhe përmbajtjes. Në të gjitha temat ka shtytje që burojnë nga shpirti i pastër i autorit, nga momentet e jetës së tij, si dhe nga ngjarjet që e rrethojnë.

Mirsadi me këtë punim të tijin, ngre zërin për të drejtat hyjnore, për vlerat e domosdoshme të të gjithë elementëve të shoqërisë duke filluar nga individit, kultura dhe trashëgimia familjare, si dhe ndërtimi i një kompleksiteti shoqëror me virtytet e edukatës Islame që, i jep kuptim jetës së kësaj bote dhe vlerat shpresuese të mëshirës hyjnore në jetën tjetër. Autori paraqet modelin e një të riu musliman që e ndërton jetën në një shoqëri moderne..."

Referatin e dytë me temë: "Bota shpirtërore e parë përmes dimensionit shpirtëror", e mbajti teologu dhe studiuesi nga Kosova, z. Ajni Sinani. Ndër të tjera ai u shpreh:

"...Lirisht mund të konkludojmë me gojë plotë se, libri 'Fjalë frymëzuese' i shkruar nga Mirsadi, është një kontribut i veshëm kundër epidemive të kohës

Synimi i këtij libri është që të vejë në dispozicion një grup të dhënash fetare që kanë të bëjnë me secilin prej nesh, e veçmas me rininë në kohën tonë, në mënyrë që të largojë shastisjen në mendje dhe grimcimin e shpirtit...

Referatin e tretë me temë: "Guxim apo ambicie?", e mbajti pedagogu në "Akademinë e arteve", Tiranë, z. Edison Çeraç. Ai theksoi rëndësinë e botimeve origjinale në gjuhën shqipe nga autorë të ndryshëm.

Referatin e fundit me temë: "Libri 'Fjalë Frymëzuese' i shikuar me syrin e një të riu", e mbajti maturanti Sead Cena. Ndër të tjera ai citoi: "... Tema të tilla si: 'Akooli', 'Për një rini më aktive në mbartjen e Islamit', 'Le të ngrëjmë një gjeneratë dinjitoze', etj., të cilat i takojnë rrafshit shoqëror, trajtohen në sfond me frymë Islame. Elementi fetar dhe këshillat e pakufizuara në kohë dhe hapësirë të fesë Islame, janë themelet e kësaj ndërtese që mban sloganin: 'Fjalë Frymëzuese'!

"... Vlera e një gjëje, në të shumtën e rasteve matet me jetëgjatësinë e saj, pra sa ka kontribuar në mardhënie horizontale me botën, thënë tjetërsisht, se sa është i aftë t'u bëjë ballë sfidave që sjell koha... Unë besoj dhe jam i sigurt se, libri 'Fjalë Frymëzuese' do t'ia dalë..."

Pas referateve përshëndeti myftiu i Shkodrës, z. Ndrëçim Sulejmani; drejtori i medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi; drejtori i medresesë "Alaudin" në Prishtinë, z. Ekrem Simnica, dhe në fund,

mësuesja kujdestare e Mirsadit znj. Shpresa Bushati.

Mbas këtyre përshëndetjeve të ngrohta, e mori fjalën autori i librit, i cili u shpreh:

"Falënderimet më të sinqerta që dalin furishëm nga shpirti, e që vazhdojnë deri në pafundësi, i perkasin Krijuesit të gjithësisë, të Gjallit, Vigjiluesit, All-Illahut të Madhëruar! Paqja dhe mëshira e Tij e pakufishme dhe madhështore, qoftë mbi zotërinë tim, Muhammedin (s.v.s)!..."

Pas këtyre dy urimeve e falënderimeve speciale, dëshiroj që të falënderoj familjen time për ndihmën e jashtëzakonshme e të pakursyer që më ka dhënë, për kujdesin që ka treguar ndaj meje, e që më krijoi mundësinë, që unë të punoj e të eci përpara!

Më pas dëshiroj të falënderoj medresenë "Haxhi Sheh Shamia" dhe drejtorin e saj, z. Kujtim Dervishi; e falënderoj me gjithë zemër për nxitjen, mbështetjen në çdo iniciativë të hajrit dhe, për respektin që ka treguar ndaj meje dhe ndaj shokëve të mi! Falënderimet zotëri Kujtim!

Një falënderim mirënjohës, kam për të gjithë stafin pedagogjik të medresesë, të gjithë mësuesit papërgjithim, të cilët nuk kursyen aspak, por më mësuan dhe më edukuan më përkushtim. Mirënjohje dhe falënderim për të gjithë!

Vazhdoj falënderimet, duke falënderuar redaktorin e librit, prof. Ilir Bejtjen, për gjithçka ka bërë për mua.

Më pas, një falënderim të veçantë kam për profesorin dhe mikun tim të ngushtë nga Kosova, z. Ajni Sinani, i cili udhëtoi një numër të konsiderueshëm kilometrash, me qëllimin e vetëm që, të prezantojë sot këtu në këtë promovim!...

Falënderoj prof. Adem Balën dhe pedagogun Edison Çeraç, për ndihmën që më kanë dhënë, dhe për çdo gjë që kanë bërë për botimin e këtij libri, të cilin ju sot keni mundësi ta shfletoni në duart tuaja.

Po ashtu, falënderoj mjeshtrin e dizajnit, Denis Dyllin, i cili ka punuar më përkushtim që libri të dalë sa më i pasur nga ana grafike!

Përfitoj nga rasti të falënderoj edhe shtëpinë botuese "Shtjefni", për botimin në mënyrë perfekte të librit!

Një falënderim tjetër i veçantë shkon për ata që më ndihmuan në aspektin financiar, në mbarëvajtjen e këtij promovimi, pra bëhet fjalë për shoqatën "Istanbul", me kryetarë z. Shuaib Bashan, dhe për një shoqëri biznesi, pronari i së cilës më ka kërkuar që mos t'ia publikoj emrin, duke dëshmuar kështu për imantin që e karakterizon këtë njeri...

Së fundi, me shpresë që të mos kem harruar kënd pa përmendur e falënderuar, po e mbyll fjalën time, duke shprehur një respekt të madh dhe konsideratë të sinqertë për ju, që më nderuat sot me pjesëmarrjen tuaj!

Edhe një herë falënderime dhe gjithmonë në tubime të tilla vëllazërore u mbledhshim! Ashtu qoftë!

Në fund, promovimi u mbyll me koktejl.

Gazetari



Mr. Feim Dragusha, Kosovë

FJALË FRYMËZUESE Mirsad Sylja

Vepra e autorit shkodran z. Mirsad Sylja, respektivisht nxënësit të Medresesë së Shkodrës, të titulluar "Fjalë Frymëzuese", të sapo botuar në Shqipëri, 2008, fq 124, paraqet një thesar të vyer mbi njohuritë e të riut shkodran Mirsad Sylja, i cili tashmë ka sjellë në dritë punën e tij të vyer "Fjalë Frymëzuese", kontribut i cili do t'i shërbejë lexuesëve të të gjitha moshave, e në veçanti të rinjve, të cilët kanë marrë rrugë dhe shtigje të gabuara, tek të cilat po ujiten për ditë e me shumë.

Për lexuesit shqipfolës vepra ka rendësi të madhe dhe te shumëfishitë, kjo për arsye se autori librin e tij e fillon me kapitullin që shtjellon çështjen e adhurimit, e në veçanti kur kihet parasysh njohja dhe respektimi ndaj Krijuesit tonë, kjo i ngjason edhe periudhes mekase, kur Pejgamberi alejhisselam, ftonte njerëzit vendor që ta adhurojnë vetëm Allahun e Madhërishtëm, më pas autori vazhdon me meditimet e krijesës, respektivisht meditimet e njeriut, ku ai lutet për shtim të diturisë së dobishme, përmes se cilës arrin deri tek njohja e Krijuesit të gjithësisë, pastaj vënia në spikame e porosive kuranore dhe atyre profetike mbi elementin me të shtrenjtë të besimtarit kohën -, ku me pas kalon në kapitullin tjetër, gjegjësisht shqetësimet, dhe mbaron veprën e tij duke vënë në spikam ca çështje të jetës së tij personale; obligime, mallëngjime, krenari, e kështu me radhë.

Libri gjithashtu nderon mundin e autorit si dhe të të gjithë atyre që ndihmuan në daljen e tij në dritë, duke mos harruar edhe faktin se kjo vepër është rezultat i një mudi të gjatë, tre vjeçar, me përmbajtje të thukët dhe përgatitje estetike, gjithnjë duke u bazuar në metodologjinë e punimeve moderne shkencore, që e bën atë më të këndshëm për lexim si dhe praktikimin e tij në jetë, gjë për te cilën është shprehur dhe autori në përfundim të librit: "...ju kërktoj, butësisht, që këshillat dhe mesazhet që morët në këtë botim, t'i praktikoni në jetë dhe t'ua përcillni edhe të tjerëve, sepse kështu e arrijmë më shumë qëllimin tonë".

Këto qenë disa nga mesazhet që deshmojnë për modestinë dhe butësinë e autorit, por në të njëjtën kohë na japin të kuptojmë guximin dhe nismën e frytshme të autorit të ri Mirsad Syljes, i cili është fryti i parë i Medresesë së Shkodrës, që në këtë moshë aq të re, me punën dhe entuziazmin e tij ka mahnitur të gjithë, prandaj, kam shpresë se libri në fjalë, do të ketë shansin të depërtojë edhe në pjesët e tjera të Ballkanit, në mënyrë që të rinjtë tanë të njihen më për së afërmi mbi përmbajtjen e librit dhe mesazhet e tij, që do t'i kontribuojnë brezave tanë dhe atyre që do vinë me vonë.

Lus Allahun e Madhërishtëm që autorit t'i japi suksese në punët e tij, jetë te gjatë, si dhe përkrahje nga mbarë dashamirët e librit. Amin!

DEBATET PER ANETARESIMIN E SHQIPERISE NE KONFERENCEN E VENDEVE ISLAMIKE



Pas zgjedhjeve pluraliste të vitit 1992, në Shqipëri erdhi në pushtet Partia Demokratike, e cila, në agjente të saj dhe në përpjekje për të siguruar mbështetje politike dhe ekonomike, realizoi anëtarësimin e Shqipërisë në një organizëm të rendësishëm ndërkombëtar, siç ishte Konferenca e Vendeve Islamike. Opinioni publik shqiptar i atyre viteve nuk pati reagime, por e shikoi këtë lëvizje politike të qeverisë demokratike si një shans më shumë për shqiptarët, sepse ato shikonin tek Konferenca e Vendeve Islamike, një bashkësi shtetesh që njihet për mbështetje politike dhe ekonomike në favor të anëtarësisë së saj. E verteta është se Konferenca Islamike ka në përbërjen e saj 57 shtete të cilat nuk janë të bashkuara mbi baza fetare, po të bashkuara mbi bazen e unitetit në mes të këtyre shteteve i cili reflektohet te partneriteti i tyre ekonomik dhe politik. Ndihamat nga vendet e Konferencës Islamike për vendin tone janë shumë të njohura nga populli shqiptar dhe nga faktori ndërkombëtar. Turqia, Irani, Libia, Arabia Saudite, Malajzia janë shtete që e ndimuan popullin shqiptar në vitet e tranzicionit duke dërguar naftë, duke ndërtuar ujësjellës, ura, spitale dhe duke operuar në hapësira të rendësishme të ekonomisë shqiptare me kontribute financiare që në të gjitha rastet ishin thuajse falas. Por, opozita e majtë socialiste nuk e priti me entuziazëm anëtarësimin e Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike dhe aq më tepër ajo e kontestoi dhe iu kundërvue asaj haptas me të gjitha mjetet që kishte në dispozicion. Opozita socialiste e vitit 1992 dhe në vitet që do të vinin pas, sulmoi së pari ish -presidentin Berisha, duke ia faturuar këtij anëtarësimi. Politikanë socialistë, në ato vite, udhëtuan deri në Bruksel për të bindë Evropën se ky veprim i Berishës do ta islamizonte vetë Evropën, thuajse bëhesh fjalë për montimin e një murtaje në Evropë. Sidomos histeria kundër anëtarësimi të Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike arriti pikun e vet, kur socialistët erdhën në pushtet në vitin 1997, të mbështetur fort nga forcat politike antishqiptare që selitë i kishin mrenda Shqipërisë dhe jashtë saj. Kuptohet se pas grekëve ishin edhe të tjerë më të fuqishëm se grekët që do të rrëzonin qeverinë demokratike për të sjellë në pushtet mafian politike të cilët e përfaqësonin të ashtuquajturit socialistë shqiptarë, bëmat i të cilëve për 8 vite ishin të pallogaritshme në dëm të interesave të kombit shqiptar. Ishte përkishtë e majta shqiptare që nuk e uli për asnjë çast penalizimin e anëtarësimi të Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike, duke angazhuar direkt politikanët e saj në këtë penalizim. Në një prononcim mediatik, Agim Nesho, ambasadori Shqipërisë në OKB, do të deklaronte se anëtarësimi i Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike e ka dëmtuar integritimin e saj në strukturat euroatlantike dhe se ajo nuk duhet të ishte bashkuar me grupe politike që kanë në bazën e tyre fenë dhe se Shqipëria duhet të jetë vetëm pjesë e Natos dhe e BE. Për politikanin socialist, anëtarësimi i Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike është i pajustificueshëm. Por, ajo që të shqetëson më shumë është

qëndrimimi i politikanëve perëndimorë, të cilët nuk munguan të kërcënojnë politikën shqiptare për anëtarësimin e Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike. Komisioni për Politikën e Jashtme i Parlamentit Evropian i kujtoi Shqipërisë për pasojat e këtij anëtarësimi në se mendon të anëtarsohet në BE. Sot, Turqia është problem për t, u anëtarësuar në BE sepse është anëtare e Konferencës së Vendeve Islamike. Edhe kur Shqipëria të bëhet kandidat për BE, do të pyetet përse u anëtarësua në këtë Konferencë.

Por, flamurin e histerisë kundër anëtarësimi të vendit tonë në këtë organizëm ndërkombëtar, do ta merrte përsipër media e shkruar dhe vizive duke na bërë të dyshojmë për një dirigjim të këtij sulmi i cili nuk do të njihet ndërprerje asnjëherë. Që në fillim, ata mallkuan ish presidentin Berisha të cilin e fokusuan si burimin e kësaj të keqeje duke e paraqitur të veshur si hoxhë, sikur fundi i Shqipërisë do t, i vinte nga anëtarësimi i saj në Konferencën e Vendeve Islamike. Ata nuk munguan që të ngrinin zërin lart dhe të çirreshin për largimin e Shqipërisë nga Konferenca e Vendeve Islamike. Ishte e qartë se do të ishin mediat e majta ata që do të ishin flamurtare të kësaj histerie antiislame duke hedhur teza të rrezikshme për raporte të paqena fetare në Shqipëri që e ulnin përqindjen e muslimanëve në 38%. Për ta bërë të pranueshme këtë shifër, u angazhuan seminare dhe simpoziume, politikanë dhe gazetarë më një biografi të thekur antiislame. Sidomos ashpër do të shpërthenin mediat, kur ministri i jashtëm spanjoll, Morinjo, gjatë një vizite në Shqipëri, do t, i kërkonte qeverisë shqiptare që të ndërmytesonte pranë vendeve të Konferencës së Vendeve Islamike për të qetësuar situatën në Lindjen e Mesme. Opinioni publik do të shikonte në mediat shqiptare tituj të tillë gazetash si ; Kur Shqipëria qenka shtet islamik, Shqipëria nuk është vend islamik, por është vend laik, Shqipëria është vend evropian. Muslimanët nuk janë praktikues të fesë së tyre dhe se ministri Morinjo kishte bërë një kërkesë të pakuptimtë dhe të pavend. Për fat të keq edhe KMSH u bë pjesë e këtij sulmi ndaj ministrit spanjoll, duke dhënë argumente jo bindëse në arsyetimet e tij, në vend që ta shfrytëzonte kërkesën e spanjollit për të rriur potencën dhe peshën e fesë islame në Shqipëri. Megjithëse politikanët e majtë, që mbështetën nga media të fuqishme, e mbajtën të ndezur zjarrin kundër anëtarësimi të Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike, ata nuk kaluan në veprime konkrete parlamentare dhe institucionale për ta larguar Shqipërinë nga kjo Konferencë, sepse ata ishin përfutues direkt të ndihmave që erdhën nga këto vendet dhe se me paratë e këtyre vendeve u bënë të pasur dhe shkolluan fëmijët e tyre në vendet perëndimore. Socialistët dhe ata që janë prapavijë e tyre nuk janë shumë të shqetësuar nga anëtarësimi i vendit tone në Konferencën e Vendeve Islamike, por në shinjestër ata kanë penalizimin e muslimanëve si rrezik për Shqipërinë dhe se shpëtimi i saj do të vinte nga mohimi i identitetit të tyre fetar, duke na kujtuar parathanien e Kuranit të botuar në Egjipt, në vitet

1990, ku Ahmet Raif do të shkruante se shqiptarët rrezikoheshin nga kthimi i tyre në krishterizëm, situatë që tashmë është e lexueshme në të gjithë hapësirat shqiptare, duke përfshirë edhe Kosovën, ku shoqata të huaja po hapin fe të tjera, sikur ne të ishim paganë dhe nevojtarë për të pasur një fe, kur të gjithë shqiptarët janë të rehatuar fetarisht. Por, do të jenë vitet, që do të pasojnë, të cilët do të vërtetojnë se qeveria demokratike kishte vepruar drejt dhe diplomatikisht largëpamëse, kur e anëtarsoi Shqipërinë në Konferencën e Vendeve Islamike. , sepse ashti, kur po vendoset fati i Kosovës, diplomacia shqiptare i ka kthyer sytë nga vendet e Konferencës së Vendeve Islamike duke marrë inkursione diplomatike drejt këtyre vendeve, inkursione në të cilat janë angazhuar drejtuesit më të lartë të politikës së shtetit shqiptar, të cilët tashmë e kanë kuptuar se ku janë miqtë e vertetë të popullit shqiptar, që na kujtojnë vitin 1992, kur në Sarajevë u demonstrua me flamujt e Turqisë, Iranit dhe Arabisë Saudite, duke i treguar botës se kush janë mbështetësit e vërtetë të muslimanëve të Bosnjes. Do të jetë kryeministri shqiptar, Sali Berisha, që bëri një vizitë në Egjipt, duke i kërkuar presidentin Mubarak që të përdorë autoritetin e tij për të influencuar tek vendet e Konferencës Islamike që ata të votojnë në bllok në OKB për të mbështetur Pavarësinë e Kosovës, vizitë që u pasua nga ajo o Kryetares së Parlamentit Shqiptar drejt Turqisë, të cilës i kërkoi mbështetje që Turqia ta përdorë autoritetin e saj të padikutueshëm ndaj vendeve të Konferencës Islamike për të kërkuar mbështetje diplomake për Pavarësinë e Kosovës, aq më tepër që jashtë kornizave të politikës dhe diplomacisë turke, nuk ka zgjidhje në Ballkan. . Zoja Topalli eci edhe më tej në inkursionin e saj politik, duke vizuar vende të tjera që janë pjesë e kësaj Konference, gjithmonë e sigurtë se atje do të gjejë mbështetje për Pavarësinë e Kosovës. Mos të harrojmë se Izraelin politikanja shqiptare nuk e pati aq larg sa të ndalohej gjatë vizitës së saj, aq ma tepër që flitet për ndihmë të shqiptarëve në mbrojtje të hebrejve gjatë luftës së dytë botërore. Por, hebrejtë duket se janë kundër Pavarësisë së Kosovës, sado t, i nderojmë me simpoziume dhe me seanca parlamentare me ftesa e vizita të hebrejve që vijmë të ftuar në Shqipëri, . sepse duket se po bëhemi miq për kokë me njëri tjetrin. Vetëm politika kosovare duket se nuk e ka kuptuar se kush janë ata që mbështesin Pavarësinë e Kosovës. Është për të ardhur keq kur kryeministri, Fatmir Sejdiu pengoi pjesëmarrjen e grupit të unitetit që ishte i ftuar në Islamabad për të marrë pjesë në punimet e ministrave të jashtëm të vendeve të Konferencës së Vendeve Islamike, e cila megjithatë votoi në bllok në mbështetje të Pavarësisë së Kosovës. Në një antitezë të plotë janë vendet evropiane të cilët për këtë çështje janë larg një uniteti në mes tyre. Spanja, Bullgaria Italia, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe patjetër ndonjë shtet tjetër evropian e kundërshtojnë Pavarësinë e Kosovës, duke treguar se shqiptarët po i dallojnë miqtë nga kundërshtarët e interesave të tyre kombëtare. dhe se sllogani që jemi në Perëndim dhe i takojmë vetëm atij, tashmë është i tejkaluar për shqiptarët. Koha ka vërtetuar se populli shqiptar, me shumicë muslimane, ka miq edhe në Lindje, të cilët janë miqtë e tij të vërtetë dhe se trojet shqiptare nuk u coptuan dhe nuk u shkretuan kurrë nga Lindja, por gjëmat shqiptarëve u erdhën gjithmonë nga Perëndimi, nga Evropa

, cila mban përgjegjësi historike për coptimin e trojeve shqiptare dhe për fatkeqësitë që pasuan. Historia që do të vijë pas do të tregojë sa Evropa është e gatshme të korigjojë gabimin e saj historik ndaj shqiptarëve duke u dhënë atyre të drejtën që u takon për të jetuar të gjithë në trojet e veta në një shtet të vetëm.

Selim Gokaj Shkodër, me 31 dhjetor 2008.

Referencat;
Agim Nesho;Konferenca Islamike, pengesë për Shqipërinë.
Amendoni se Tirana zyrtare duhet të vendosë për daljen Nga Konferenca e Vendeve Islamike;Gazeta Koha Jonë 14 gusht 2006
Olsi Jazexhi : Histeri me Konferencën Islamike Paralajmërohet Shqipëria Për Konferencën Islamike;Gazeta Shqiptare 30 shtator 2006
Qysh kur Shqipëria është shtet islamik;gazeta shqiptare, 28 shtator 2006.

Rrefime antiislame te nje agjenti te njohur anglez

Këto materiale që ne po i hedhim në media janë kujtime të agjentit anglez ,Harper, i cili në librin e tij ,'Rrëfimet e agjentit anglez', tregon për detyrat që u ngarkonte shteti anglez agjentëve të tyre për të shkatërruar Perendorinë Osmane . Ne menduam që të t'ia bëjmë të njohura këto materiale lexuesit duke pasë parasysh që ato ruajnë jo vetëm vlerë njohëse për atë kohë për të cilën dëshmon agjenti anglez Harper , por edhe për faktin se edhe sot, në forma të sofistikuara dhe shumë here edhe krejt haptas ,vazhdon përpjekja për të dëmtuar muslimanët ,shtetet e tyre dhe mbi gjithshka pikësynimi kryesor për të goditur imazhin e fesë islame dhe vlerat e saj hyjnore .Ne mendojmë që materiali të jepet i koncentruar duke ndjekur një rrallitje për sejcilën detyrë që merrnin agjentët anglezë për të rrënuar Perëndorinë Osmane e cila ishte edhe simbol i fesë islame ,kur kemi parasysh se në këtë perendori ishte i nstaluar dhe vepronte Kalifati Islam, si qendër e fesë islame për të gjithë muslimanët në të gjithë botën.

1.Ne duhet të botojmë libra që do të sjellin ngatërresa në mes të muslimanëve në të gjithë botën

2.Eshtë detyrë e jona që të shpifim kundër të gjithë njerëzve të fesë me qëllim që të rinjtë të largohen nga feja dhe të mbesin injorantë

3.Duhet të pengojmë shtetin që të mos i dënojë hajdutët dhe kriminelët dhe po shteti duhet t'i paisë ata me armë

4.Duhet të dëmtohet ekonomia e vendeve muslimane duke shkatërruar qendrat e yre të bamiresisë duke fundosur anije,duke djegur



tregjet dhe duke helmuar ujrat e pishëm

5.Ka shumë rendësi që ne duhet të shpifim për dijetarët muslimanë dhe duhet që disa agjentë nga rrallët tona të maskohen si dijetarë muslimanë dhe të dalin rrugëve duke kryer akte të ulta dhe të dënueshme nga opinjoni shoqëror

6.Duhet të përhapim imoralitetin ndër muslimanë pijet alkoolik, kumarin dhe mishin e derrit

7 Të bëhen përpjekje për të larguar muslimanët nga ibadeti duke nxerrë fetfa të rreme sipas të cilave të thuhet se Allahu nuk ka nevojë për ibadetin e njerëzve.

8 Duhet fajsuar feja islame si fe e terrorit dhe si fe e injorancës

9Ka shumë rendësi që të largojmë fëmijët nga prindërit duke i lënë jashtë edukates islame të cilën fëmijët e muslimanëve e marrin në një masë të madhe nga prindërit e tyre.

10.Eshtë me shumë rëndësi që gruaja muslimane të detyrohet të heqë shaminë nga koka duke u krijuar vështirësi në të gjitha fushat

e jetës ku ajo deyrohet të marrë pjesë.

11Duhet të krijohen kushte të tilla që të kufizohen lindjet dhe të krijohen ligje që të vishtirësojnë martesat e muslimanëve.

12Ka rendësi të jashtzakonshme që të pakësohen qendrat bamirëse muslimane dhe, kur ato egzistojnë, duhet t'u kalonë organeve shtetërore

Në kujtimet e tij ,të cilat agjenti i njohur anglez i ka botuar në këtë libër, ai tregon se në një takim me sekretarinë ministrisë angleze, ai i kishte dhënë Hapnerit një libër që ky e quan të përsosur, sepse aty tregohet për të gjitha punët që ne duhet të kryenim për të nxerrë jashtë loje

Perendorinë e Famshme Osmane.

Sekretari i ministriesë i kishte thenë agjentit të tij se qeveria angleze kishte edhe shumë njerëz të tjerë që po bënin të njëjtën punë si Hapneri. Deri tani këtë punë e bëjnë 5000 agjentë, duke synuar që këtë numur ta rrisim deri në 10000 të tjerë me qëllim që të kemi në dorë të gjithë muslimanët e botës dhe të gjitha shtetet muslimane të botës.

Kujtojmë për lexuesit tone të nderuar se këto kujtime ,që vijnë nga një perudhe kohore relativisht e largët ,na bëjnë të besojmë se kundër muslimanëve ka qënë në këmbë një konspiracion i madh dhe shumë i rrezikshëm i cili jemi të sigurtë se është aktiv edhe sot ,duke vepruar me të njëjtën strategji që kulmon me penalizimin e muslimanëve si terroristë dhe të fesë slame si fe terroriste e cila është kopje e portretit që agjentura angleze u bente muslimanëve dhe fesë islame në ato vite, kur muslimanët kishin një kështjellë të fuqishme mbrojtjeje ,siç ishte Perendoria Osmane.

Genti Kraja

KRYEPROKURORJA E GJYKATES SE HAGES PERFUNDOI MANDATIN E SAJ



Mediat vizive dhe të shkruara ,kombëtare dhe ndërkombëtare, i bënë shumë jehonë përfundimit të mandatit të Karla Del Pontes, si kryeprokurore eHagës ,duke vënë në dukje rolon e saj në dënimin e kriminelëve të luftës në ish-Jugosllavi. Por, Karla Del Ponte do të kujtohet edhe për anën tjetër të medaljes ,e cila është portreti i vërtetë i saj dhe i misionit që ajo realizoi si kreu i kësaj gjykate .E formuar sapo mbaroi lufta etnike fetare në ish- Jugosllavi për të dënuar kriminelët e kësaj lufte, ajo në fak kishte një mision më specifik për të kryer i cili synonte që të amortizonte krimet serbe dhe kroate ndaj muslimanëve në Bosnje dhe Kosovë dhe synonte gjithashtu që të dërgonte sa më shumë luftarë dhe komandantë boshnjakë dhe kosovarë në bankën e të akuzuarve në Hagë që viktimat të barazohej me kriminelin, anipse muslimanët në Bosnje dhe në Kosovë mbroheshin që të shpëtonin nga masakrat dhe përdhunimet e kriminelëve serbë. Ishte Karla Del Ponte që u bë pjesë e komplotit ndërkombëtar kundër muslimanëve në Bosnje, duke

shpëtuar nga prangat e arrestimit vrasësit dhe gjakatarët, Karaxhiç dhe Mlladiç të cilët janë duket të mbrojtur nga paqja antimuslimane e Dejttonit më të cilën ishte në një linjë edhe Karla e vogël e cila, kur donte, bënte gjema të mëdha sidomos ndaj luftëtarve muslimanë që luftuan për liri në Bosnje dhe në Kosovë. Mediat e huaja(sepse mediat shqiptare nuk dihet cilën anë mbajnë , kuptoht se anën e muslimanëve kurrë),e kanë kontestuar më se një here publikisht njëanshmërinë e kësaj prokuroreje që duket se nuk mund t'i shmangej programimit që i kishin bërë ato që e kishin vendosur në atë karrige aq të rëndësishme, ku edhe kriminelit mund të kishte pranë viktimit e tij, i akuzuar edhe ai për krime kundër njerëzimit me një mandat arresti nga Karla italiane që si shumë italianë, me pushtet dhe pa pushtet ,kanë miqësi dhe mëshirë kristiane për serbët edhe pse serbët e Serbisë u treguan vrasës dhe kriminelë ndaj muslimanëve për të cilët mëshira e Karlës prokurore ishte me pikatore. Janari 2008 tashmë e gjen Karla Del Poten të ngritur nga karriga e kryeprokurores se Hagës, një largim i turpshëm dhë poshtrues, sepse ajo ,me prapavijën që përfaqësonte, la të lire ata që masakruan qindra dhe mijra muslimanë në Bosnje. kriminelët ,Karaxhiç dhe Mlladiç që pa tjetër festuan dhe e falenderuan nga larg këtë italiane mikeshë që ua hoqi nga zverku litarin dhe i la të sillen të lire sikur të kishi vlarë rosa dhe jo njerëz të pafajshëm Puplat tashmë i kanë rënë Karlës që aq fort e ngrinte zërin dikur kur kishte aq pushtet sa ia lejonte padroni.. Tashmë pa tjetër Karla Del Ponte e ndien patjetër vehten një figureë që la pas një emër. Por, ato që do t'ia vënë emrin e vërtetë janë viktimat e kësaj lufte të egër që u ndez me urdhër dhe u ndalua po me urdhër të atyre që e planifikuan këtë luftë e cila synonte të krijonte kufij të rinj dhe harta të reja në Ballkan ku muslimanët të jetonin në hapësira sa më të

vogla dhe të jetonin sa më të varfër dhe sa më të diskriminuar. Sot, pas 12 vitesh, kur lufta ka përfunduar, lehtësisht mund të shikohet se ustallarët antimuslimanë që gjakosën hapësirat e ish-jugosllavisë, ku jetonin muslimanët ,i kanë realizuar thaujse plotësisht planet e tyre. Sot, në Bosnje, muslimanët jetojnë në një të tretën e hapësirës së shtetit boshnjak, duke qënë edhe hapësira më e varfër në Ballkan. Kurse Kosova po vuan pasluftën e fundit në një qorrrok politik të cilit nuk i dihet lehtë fundi Dhe këtyre dhimbjeve për viktimat e vrara dhe viktimat e zhdukura u shtohen edhe viktimat që po gjykohe në gjykatën ndërkombëtare të Hagës vetëm sepse ato luftuan kundër armatës serbe dhe paramilitarve serbë që të jetë sa më i vogël numuri i viktimave dhe i kriminelëve.Këto luftëtarë dhe komandantë ushtarakë kosovarë dhe muslimanë boshnjakë do ta shohin vehten të lire, kur të jetë demaskuar dhe dënuar Karla Del Ponte dhe prapavija që e ngriti në atë detyrë dhe që e mbështeti veprimtarinë e saj që ishte aq larg nga drejtësia e vërtetë për të cilën ajo shte betuar si gjykatëse

Karla u largua. Ata që do të vendosin një Karlë të Re në Gjykatën e Hagës duket se po planifikojnë edhe punë të reja për kryeprokuroren e re e cila do të ketë të bëjë me kriminelë të rinj dhe me viktimat të reja, sepse në Ballkan duket se po përgaditen ngjarje të reja të cilat si gjithmonë do të kenë viktimat që janë bërë traditë të jenë viktimat . Dhe këto janë muslimanët e Ballkani që i dënoi ashpër Karla e Vjetër dhe që pa tjetër edhe më ashpër do t'i dënoje Karla e Re.

Selim Gokaj Shkodër me 1 janar 2008

SHIKONIM ME DHIMJE....



Momenti i rrënimit të xhamisë së Parrucës që ishte pjesë e fëmijërisë sime e cila nuk do do më shlyhet nga kujtesa


bedenat e forta të mureve të xhamisë mbeten se mbeten e ne vrisnim mendjen se sa të forta paskan qenë! Na paten thenë se arsyeja e prishjes së xhamisë ishte drejtimi i rrugës e cila kurrë s'u drejtua. Mbaj mend se, pasi e prishën xhaminë e Parrucës, ambjentin e mrendshëm të xhamisë e dhanë për estradë. Ne ,si fëmijë, kur futeshim mbrenda, më shumë shikonim ambjentet e mrendshme të saj që ishin një bukuri e rrallë, se sa shfaqjen dhe çdo njëri prej nesh në fundin e shfaqjes dilte me një keqardhje të madhe për xhaminë që u shkatërrua padrejtësisht.

Astrit Dervishi
Mësues në Dajç-Shkodër
Nga arkivi i mediave të shkruara

Më kujtohet si sot, kur mësuesi futej në klasë me gotën e ujit në dorë për të na prishur agjërimin .Ishte kjo dukuri i viteve 60. Shumë nga shokët e mi , duke përfshirë edhe djalin e Hafiz Xhemës, iknim nga klasa në orët e para të mësimit ,që të mos na e prishnin agjërimin e ramazanit. Më vonë unë e kuptova se ky veprim ishte pjesë e një skenari të tmerrshëm, sepse tashmë kishte filluar fushata kundër fesë.Vazhdimisht kaloja pranë xhamisë së Parrucës, që ishte më e bukura , me shumë minare ,sepse rruga për në shkollë më sillte pranë saj dhe nga ana, tjetër unë me Seidin, që ishte djali i myftiut të Shkodrës të cilin e kisha shok fëmijërije, luanin së bashku në oborrin e saj..Neve na dukej se minaret e saj dhe muhabeti i pleqve, që bëhej përherë në këtë xhami , kishte diçka hyjnore dhe ne vazhdimisht thithnin nga ky nektar hyjnor Mjerisht u hapen fjalë, si rrufe, për prishjen e institucioneve fetare , përfshirë këtu edhe gëzimin tone, xhaminë e Parrucës.Ne na dukej se po na sulmonin qenien tone. Filloi prishja e mureve anësore. Shumë besimtarë mallkonin, qanin dhe binin shehadet dhe ne nuk besonin atë që po ndodhte të cilën po shikonim. U hapen fjalë se Zoti do do të marrë hak ndaj atyre që po prishnin xhaminë.Ne nuk dinim se kush ishin ata që ishin shkatërruesit e xhamisë të cilët ne na dukeshin djaj , armiq të xhamisë. Në fillim u rrëzuan minaret , si edhe filloi rrënimi i ambjentit të mbrendshëm. Ne shikonim me nostalgji që po na prishej caku ynë i vetëm. Ishim kureshtarë për çdo gjë.Më vonë doli fjala se një njeri vdiq nga ata që po prishnin xhaminë dhe se ai ra nga skela.. Ne thamë se zoti e mori hakun Ne na dukej se u përmbys bota.Të vdekurit nuk i vendosnin më në atë pllakën e madhe të gurtë për t'ua falur xhenazën që ne na dukej se burrat po përshëndeteshin me të vdekurin për të fundit here.Dhe çuditësim që nuk ndigjonm zërin melodioz nga minaret që ishte tepër kumbues dhe i thekshëm. Si fëmijë ,çuditësha se si zinzhirët e buldozerëve lëvtronin përrreth, kurse minaret qëndronin të forta, por të zymta, si qëndresë e fundit. E dija se unë po "gaboja",sepse po qëndroja para skenave të tilla. Si një nxënës i mire që isha dhe si bir i prindërve intelektualë duhej të isha i disiplinuar dhe i ndigjueshëm ...duhej të ikja dhe të mos shikoja.Por, diçka ndija se po më rrënohej edhe nga qenia ime e fëmijërisë.Mbaj mend se ata

TE GJITHA FAJET NUK ISHIN TE HAXHI QAMILIT

Flet shefi i departamentit të Institutit të Historisë Gazmend Shpuza



T e k s a vargun e izmave që kërkojnë të fshihen pas "bëmave të Haxhi Qamilit" Sipas Gazmend Shpuzës, e vetmja dekorate që ka marrë Haxhi Qamil ka qenë dekorata që i akordoi komandanti i famshëm turk i garnizonit të Shkodrës, Hasan Riza Pasha në vitin 1912, sepse në betejat që u bënë për të mbrojtur Shkodrën nga forcat shoviniste malazeze,Haxhi Qamili u plagos dhe u dallua për trimëri. Në ato vite ai nuk ishte i detyruar të shkonte në luftë, sepse ishte shumë i ri Por, Haxhi Qamili mori pjesë vullnetarisht në mbrojtje të qytetit të Shkodrës.Duket se për historianin Gazmend Shpuza sulmi i vazhdueshëm kundër figurës së Haxhi Qamilit është pjesë e përpjekjeve për të theksuar identitetin evropian të shqiptarve duke e treguar dhe paraqitur atë si ithtar të një princi musliman për të cilën në atë kohë ishte dakort edhe Ismail Qemali dhe shumë priftërinj katolikë Ne duhet ta kemi të qartë, vazhdon historiani argumentues, Gazmend Shpuza, se rebelimi antikombëtar esadist, grekoman dhe turkoman i viteve 1913-1915 nuk mund të mbulohej, as dje dhe as sot, me akuza kundër Haxhi Qamilit dhe kundër "haxhiqamilizmit..Për hir të vërtetës duhet pranuar se Haxhi Qamili ishte besimtar, por nuk ishte fanatik.Ne nuk kemi të drejtë t'ia veshim edhe gjynahet e të tjerëve, sepse ai kishte mjaft gjynahet e veta. Haxhi Qamili nuk ka qenë asnjëherë udhëheqësi i kryengritjes kundër princ Vidit në Shqipëri, por ai ishte në ballë të kryengritjes kundër tradhëtisë esadiste.Nuk duhet të harrojmë, e përfundon itervsistën e tij tek gazeta Tirana Oserver historiani Gazmend Shpuza, se për atdhetarët e vërtetë të viteve 1913 1915 nuk ishte shqetësim turkomanizmi i Haxhi Qamilit ,por grekomanizmi i Zagrafos dhe i dhespotëve,grekë të Durrësit e të Korçës dhe pse jo edhe turkomanizmi i Musa Qazimit

vërtetave hitorike që kanë lidhje me ngjarje të rëndësishme që janë pjesë e jetës së popullit shqëptar Eshtë Gazmend Shpuza , një figurë që drejtoi me sukses Bibliotekën Kombëtare dhe një ndër ato figura që i kanë dhënë tonin studimit të historisë sonë kombëtare.Eshtë ky historin që nuk është dakort se të gjitha fajet për atë vit të mrapshtë, pas Pavarësisë ,ishin të Haxhi Qamilit i cili kishte edhe anë negative, por jo të asaj shkalle, sa ai të kthehet në një metaforë ,ose krahasim për mediat shqiptare dhe politikanët shqiptarë, kur ata duan të etiketojnë një dukuri negative ,si nga historia e popullit tone, ashtu edhe dukuri të tjera të jetës shoqërore aq sa, ai po lakohet edhe nga njerëz të tillë që vetëm e dine se dikush në ato vite quhej Haxhi Qamil dhe luftonte që të montonte në Shqipëri një Turqi të vogël ,propogandë kjo e paditur dhe e qëllimshme. Përpjekjet për ta demonizuar figurën e Haxhi Qamilit synojnë që përgjegjësinë për atë periudhë të mbushur me shumë probleme t'ia faturojnë popullit të thjeshtë ,duke mbuluar përgjegjesit e vërtetë të atyre ngjarjeve të dhimshme si: esadizmi ,grekomanizmi ,vidizmi turkomanizmi dhe izma të tjera që mund ta rrisin

Nga arkivi i mediave të shkruara

ISLAMI ESHTE MBROJTESI I KOMBIT TONE

Allahu i nderoftë t' parët tone ,që Islamin përqaftuan
 Me urtësinë e tyre mbrojtjen e kombin siguruan.
 Në këtë botë dhe n' Ahiret të shpëtuar ata janë
 Se amanetin e Allahut e ruajtën të sigurt e lane.
 Le ta dijnë mire , të gjithë le ta dine
 Feja Islame e mbrojt dhe e mbron Shqipërinë.
 Islami nuk u përhap me zjarr e majen e shpatës
 Por me imanin ma i ambël se shija e mjalhtës.
 Islami është ai që mbrojt shqiptarin
 Sepse ndryshe do të kishim mbret Gospodarin.
 Shumica shqiptare Islamn kishte kuptue
 Me zemër e mendje atë kishte përqaftue.
 Por kishte prej atyre që muslimanë nuk u bane
 Kombësinë shqiptare ortodoksisë ia dhanë.
 Po t' mos ishte Islami , i dashuri jaran
 Të gjithë do t'ishim Vasiliqa ,Sllabodan.
 Heroi i grekëve është Marko Boçari
 Me fe ortodoks, por me gjak shqiptari.
 Por, kisha ortodokse ashtu urdhëroi
 E la gjakun shqiptar, grekun përqaftoi.
 N' Mal të Zi ishte Mark Milani
 Ai vëlla e pris bani Gospodarin.
 Feja Islame me t' madhe thekson
 Fise , kombe , gjuhë ruen dhe nderon.
 Me Madhnin e Vet Allahu bani
 Secilit komb t'i njihet qartë tabani.
 Të gjithë i shijuantë mirat e Islamit
 Pashko Vasa, valiu i Libanit
 Pashai i Mirditës katolik ishte
 Te Sulltani vend nderi kshte
 N, ajete t, Kur-anit me theks shkruhet
 Kombësi dhe gjuhë me kujdes t' ruhen.
 Ka pelivana që kërcejnë ..e na thonë
 Kthimi n' krishterizëm është ,nët' mirën tone.
 Ata pallavra s' hahen e s' shkojnë
 Vet evropianët drejt Islamit marshojnë.
 Jo vetëm Evropa, por bota mbarë
 Kjo e vertetë Hyjnore kah here është pare.
 Kongresmeni i pare musliman ,Sh,B.A.
 N, Ku-ran t'Xhefersonit betim ka ba
 Zezaku Keith Ellison
 Amerikën e Islamin n'Kongres përfaqëson .
 Për kalemxhijtë që shiten e blehen
 Anëtarë parlamenti musliman n'Angli
 S'shpejti n'Francë dhe n'Gjermani
 T'gjithë këta qartë tregojnë
 Se popujt e botës Islamin nderojnë
 Mirësitë e Islamit nga injoranca s' zhbëhen.
 Muslimanët janë damari i gjallërisë
 Shembull i përkryer n'trevat e Shqipërisë.
 Por ,greqët dhe sllavët me force e intriga
 Ku s,hyn dallaverja, leva ishte frika.
 E me para e llahtari greke e shkja
 Muslimanët ortodoks me dhun kan ba.
 Sot varfëria që na la pas komunizmi
 Na bën t'bijm pre te greku e sllavizmi.
 Shqiptar! Nga fitimi material mos u ndiqni
 Mos lejoni vehten për kapistër t'tërhiqeni.
 Mos e bani vehten vegël të Greqisë
 Mos braktisni ju të mirat e Shqipërisë.
 Ata ju keqpërdorin dhe ju përdhunojnë
 Si sllavët ata sot po ju trajtojnë.
 Ka shumë femra tona shqiptare
 Që për letra udhëtimi e për pak pare
 N'pazare t'botës si gjaja shiten
 Nanat tona fisnike këto turpe s'ditën.
 Nanat tona dikur djem e vajza rriten
 Për nder n,zjarr t,hidhen kurr s,priten.
 T, gjitha këto fatkeqësi që n,kuriz vuajmë
 Faturat e komunizmit ende paguajmë.
 O vëllazën e motra kudo që jeni
 Mendje e zemër te Allahu ktheni.
 Ti musliman, mos u struk mos, u tkurr
 Lartesoje vehten ,mos u zvoglo kurr.
 Studjoje Islamin se gjen madhësitinë
 Të mbrosh vehten edhe kombësinë.
 Besimin e patundur n,Allah e kam
 E mira asht ruajt dhe ruhet n, Islam

**Burhan Al Din Fili
 New Mexico Sh.B.A**

ÇALLMA E MUSLIMANEVE NUK ESHTE HELMETA E NAZISTEVE



Në një edicion lajmesh të ores 19,30 të dates 26 shkurt 2008, televizioni Top Chenell dha një lajm që i dha r e n d ë s i sensacionale, sipas të cilit ishte botuar një foto në mediat amerikane që tregonte kandidatin demokrat, Obama, me një çallëm në kokë gjatë një vizite në Kenia.

Komenti vazhdonte duke theksuar se kjo fotografi ishte një minus i madh për Obamën dhe i shtonte mundësitë e fitores së Hillari Klintonit dhe i shtonte gjithashtu mundësitë e humbjes së kandidatit Obama, duke nënkuptuar, ose e thenë haptas ,se ishte çallma molla e sherrit që e ngriti temperaturën në garën elektorale në mes të kandidatit Obama dhe kandidatës Klinton. Duke e përcjellë një lajm të tillë ,njeriu ndjen një shqetësim dhe një shok të vërtetë, kur shikon të penalizohen simbolet e muslimanëve nga mediat më të mëdha botërore të cilat po i bëjnë jehonë garës prezicenciale në ShBA

Që nga shikuesit janë përceptuar si media asnjane dhe pasqyrë e mendimit të lire dhe të

paparagjykuar. Por, ka shumë mundësi që edhe mediat më prestigjoze janë sëmure nga sindromi antimusliman që tashmë ka përfshirë hapsira të pafund të jetës shoqërore dhe politike në të gjithë botën aq sa ,këto modele dhe steriotipe antiislame ,po bëhen pjesë edhe të garës presidenciale në Amerikë. Duhet t,u kujtojmë mediave në të gjithë hapësirat ,ku ata operojnë, se çallma e muslimanëve nuk është helmata e nazistëve ,sepse ajo mund të jetë pjesë e veshjes ë zakonshme e një muslimani ,ose pjesë e uniformës së një kleriku musliman të cilët nuk mund të paraqiten si rrezik, por si vlerë njerëzore . Nuk e dime se a do të ngrinin zërin mediat botërore po të kishte zbuluar dikush një foto të Obamas me një kryq në qafë ose në një meshë në një kishë protestane apo katolike .Zhurma të tilla mediatike për çallma apo hoxhë që paraqiten si rrezik për njerëz të veçantë ,apo edhe për vetë shoqërinë njerëzore nuk bëjnë gjë tjetër, por acarojnë dhe minojnë bashkëegzistencën në mes të civilizimeve, duke u bërë atyre një portret bardh e zi i që nuk është portreti i vërtetë i tyre ,sepse nuk mund të thuhet e të pranohet qe nëpër xhamia dhe tek njerëzit me çallma fshihen terroristë dhe vrasës, kurse nëpër kisha e manastire rriten pëllumba që, pasi dalin nga dyert e kishave dhe manastireve, rrezatojnë paqë në të gjithë planetin.

Selim Gokaj Shkodër me ,27 2.2008

FERMANI I FATIH SULLTAN MEHMETIT



Dokumenti më i vjetër mbi të të drejtat e njeriut në historinë njerëzore.

dinjitetin e këtyre njerëzve dhe nuk do t,i dëmtojë.ata..Askush të mos çënojë jetën, pasurinë dhe kishat e këtyre njerëzve, të mos i shohë e mos t,i trajtojë keq dhe të mos i rrezikojë.Edhe nëse sjellin njerëzit e tyre nga një vend tjetër në shtetin tim, ata do të gëzojnë dhe do të kenë të njëjtat të drejta.Duke e shpallur dhe duke e dekretuar këtë Ferman të Padishahut ,betohem në emër të Allahut,(Krijuesit , Zotit të tokës dhe qiellit), të dërguarit të Allahut, Pejgamrit tone të shenjtë, Muhamedit e 124 mijë pejgamerëve dhe më emër të shpatës që kam ngjeshur në brez, se asnjë nga shtetasit e mij ,të cilët do t,i binden urdhërave e do të mbesin besnikë të mij, nuk do të veprojnë në kundërshtim me çka shkruhet në këtë ferman.

Unë, Fatih Sulltan Han shpall para gjithë Botës se Françeskanët e Bosnjes, për të cilët del ky ferman,janë nën mbrojtjen time dhe urdhëroj; As njerëzit, emrat e të cilëve shpallen këtu dhe as kishat e tyre të mos shqetësohen e të mos dëmtohen.Le të jetojnë në paqë e të qetë ata mbrenda Perëndorisë time.Të gjithë këto njerëz, të rënë në gjendje refugjati le të jetojnë të lirë e të sigurtë. Le të këthehen ata në çdo pjesë të Perëndorisë time e të vendosen e të sistemohen pa frikë nëpër manastiret e tyre. Askush nga rrethi i nderuar i Padishahut, nga vezirët dhe nga nëpunësit e mi, nga shërbëtorët dhe qytetarët e Perëndorisë, nuk do të çënojë

Shkruar në Milodrazh Me, 28 maj 1463 Originali i këtij Fermani ruhet në kishën Françeskane në Fojnicë të BosnjeHercegovinës. Kjo shpallje e Fatih Sulltan Mehmetit, e shkruar në vitin 1463, 326 vjet përpara Revolucionit Francez të vitit 1879 dhe 485 vjet para Deklaratës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, njihet e pranohet në shumë rrethe historike e shkencore me zë, si dokumentim më i vjetër mbi të drejtat e njeriut.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Ju keni të drejtë të blini ku të doni por hallalli i vërtetë është vetëm tek market "ISMETI"

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bamirës Islam), ju afrojmë prodhime nga me të thjeshtat deri në dhoma gjumi. Shërbehet në kohë dhe me cilësi të lartë:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zyresh
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tonë dhe do të mbeteni të kënaqur. Mund të kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

